



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNES-MALISHEVE
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVE-SKUPSTINA OPSTINE MALISHEVO



PRANUAR ME: 02/02/2021.
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 02/32



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/_____

Datë: 02.02.2021

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -III-(tretë) urgjente të Kuvendit Komunal të Malishevës

RENDI DITES

1. Bartjen e mjeteve nga fondi rezervë në kategoritë ekonomike, sipas kërkesës nr.04/78 datë:
18.09.2020 të parashtruar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Mbledhja mbahet me datë: 21.09.2020 dhe filloi në ora 10:15 .Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 23 asambleistë, drejtorë komunalë, zyra për informim.

Rrahim Morina: Fillimisht pershendes Kryetarin z. Begaj, antarët e Kuvendit dhe gjithë të pranishmit në këtë sallë! Prezent janë 23 prej gjithësej 31 asambleistëve. Shpërndarjen e materialit e kemi bërë pak me vones, kërkesa është bërë pas dite dhe materialin e mbledhjes së rregulltë dhe mbledhjes së urgjente e kemi shpërndarë në të njejtën kohë, po kërkoj falje që dikujt nuk i ka shkuar në vend, por besoj që e keni marrur të gjithë materialin.

Hapi mbledhjen e III-tretë urgjente , e thirrur nga Kryetari i Komunës z. Ragip Begaj . Pika e vetme e rendit të dites është shqyrtimi dhe miratimi i kërkeses nr.01/933 datë 18.09.2020, të Kryetarit të Komunës për thirrjen e mbledhjes urgjente, në lidhje me bartjen e mjeteve nga fondi rezerv në kategorit ekonomike, sipas kërkeses nr.04/78 datë 18.09.2020 e parashtruar nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.

Kush është për këtë rend të dites?

Për:20

Kundër:0

Apstenim:3

Me 20 vota për, asnjë kundër dhe 3 apstenime, aprovohet rendi i dites.

Kalojmë në rendin e dites, lus Kryetarin e Komunës që në pika të shkurtëra ta paraqesë këtë pikë.

Ragip Begaj: I nderuar Kryesues, të nderuar asambleistë dhe ju të tjerë pjesmarrës në këtë mbledhje urgjente! E kam parë të arsyeshme me thirr këtë mbledhje dhe ju falenderoj për përgjegjien e juaj në piken e rendit të dites, bartja e mjeteve nga ai fond për realizimin e projekteve që janë të kontraktuar. Drejtoria e ka bërë një raport që e ka paraqitur tek ju, dhe është e natyrshme që unë të kërkoj që të barten mjetet aty ku janë të realizueshme për këtë vit. Unë e di që ka ide të ndryshme e mendime të ndryshme, por unë kërkoj nga ju që këto mjete të barten aty ku janë të realizueshme dhe të kontraktume. Projektet që janë të kontraktume ata i marrin, por mos të kemi dame, kompenzime të njerëzve për shkak të përmbaruesve, por të realizohen projekte që i kemi në realizim e sipër.

Nuk do ta zgjasë shumë sepse i keni të shënuara qka ka paraparë drejtoria dhe cilat projekte mund të realizohen. Ne e kemi buxhetin në mbledhjen e ardhshme dhe besoj se dhe aty jepni mendimet e juaja dhe projektet që janë të mundura me u realizu, të realizohen ato projekte që ne kemi mundësinë me i kryer si qeveri komunale. Vitin e kaluar kemi pasur ngecje për shkak se skemi pasur marrveshje si duhet, por cili do projekt që kryhet, kryhet në interes të qytetarëve tonë. Unë ju dëshiroj sukses në punën e juaj dhe kërkoj bashkpunim të sinqert.

Rrahim Morina: Faleminderit Kryetar! Hapim debat rreth kësaj pike. Sylë Dukolli e ka fjalën.

Sylë Dukolli:Faleminderit Kryesues! Pershendetje për Kryetarin, për ju kolegë asambleistë dhe gjithë ju të pranishëm në sallë! Sot u thirrëm nga Kryetari në mbledhje urgjente për ndarjen e mjeteve, të cilat janë mbledhur në këtë fond rezervë, këto kanë rrjedhur nga ligji i pagave, i cili ligj ka shkuar në Gjykatën Kushtetuese propozuar nga shumë agjensione që marrin paga dhe ka përfunduar që nuk është hyrë në fuqi. Një marrveshje kanë pasur dhe drejtori i jonë ka marrur pjesë në atë mbledhje të të gjitha Komunave, ku kanë thënë që këto mjete mund të ndahen nga fondi rezerv, për mallra dhe shërbime dhe këtë tabelën që e keni për shërbime kapitale dhe subvencione e transfere, pra janë mjetë të cilat kanë tepruar nga mos zbatimi i ligjit të pagave të qeverisë së Kosovës. Si pasqyr reale të raportit e kemi përpara që e ka ndarë ekzekutivi, ne si Nismë e dimë që këto mjete të përdoren për projekte kapitale, për mallra dhe shërbime dhe për gjitha këto kategori, që disa ndërtime janë për kubza, për ndërtimin e objekteve të emergjencës janë të nevojshme si projekte kapitale dhe këto mjete na hyjnë në punë për me kry punë të mira dhe të mëdhaja në Komunën tonë, prandaj jo vetëm grupi i Nism-es, por gjithë ju kolegë duke pasur parasysh atë reciprocitetin që ne gjithë jemi për qytetarët e Komunës sonë, tia bëjmë një nder, një hap dhe ti shtojmë projektet kapitale, por edhe tu pergjigjemi gjithë atyre përmbaruesve të cilët kanë fituar të drejtën, të gjithë ata arsimtar ose profesor për ti fituar të drejtën e tyre që është një ligj për kontratën publike, prandaj është mirë që në këtë verzion ti japim po propozimit të ardhur nga Kryetari i Komunës. Faleminderit!

Rrahim Morina: Alban Krasniqi e ka fjalën.

Alban Krasniqi:Faleminderit Kryesues! U detyrova të sjelli një numer të madh të dokumenteve, kryesisht buxheti për shpenzimet kapitale 2019-2020 dhe planifikimi 2021, sepse pa i pasur me vete këto buxhete dhe me i analizuar, sidomos te pjesa kapitale është e vështirë të dihet se cili është qëllimi i vërtet i transferit të këtyre mjeteve, dhe nëse e shohim buxhetin për këto tri vite, vitit aktual që jeni duke e shpenzuar buxhetin e vitit 2019 i cili tashmë do duhet të ishte i realizueshem dhe i cili fatkësisht ende realizohet pjesë të atij buxheti dhe planifikimin për vitin 2021 shohim që është një mishmash i madh, që nënkupton se qeverisja komunale në Malishevë po vuan nga pa dija, nga injoranca, nga mungesa e profesionalizmit, si dhe nga një qasje hat hok e trajtimit të investimeve kapitale. Kjo kërkesë këtu që e kemi nuk ka të bëjë shumë me mjetet të cilat kanë ardhur si tepriçë e mos realizimit të ligjit për pagat, ka të bëjë me mbulimin e keq qeverisjes dhe keq menaxhimit të Komunës së Malishevës, e para për tu futur në detaje përveq një table që keni marrur një përshkrim të detajuar mbi arsyeshmërinë se pse këto mjete duhet me u bartë në këto kategori apo projekte që janë emërtu këtu. Një arsyeshmëri të shkurtë, dhe për mua të paqartë e dha Kryetari i Komunës, një tentim të tillë për arsyetim e ka pasur më herët dhe Drejtori i Financave, mirëpo ato arsytme duhet me qenë të mbështetura në dokumente konkrete që nënkupton projektet, kontratat të cilat janë në realizim e sipër dhe një dëshmi që nuk ka mjete të mjaftueshme për

realizimin e këtyre kontratave dhe si rrjedhojë paraqitet nevoja për mjete shtesë për këto projekte.

2. U tha projektizimi, mbi qfarë baze është bërë projektizimi i projekteve që dojn me i realizu tani. Shumë prej juve i shihni që fshatrat prej nga vini nuk janë të përfshime në këtë bartje të projekteve dhe shohim bartje të mjeteve në disa prej fshatrave apo projekteve që ndodhin në fshatrat ku janë një pjesë tjetër e asambleistëve, ne duhet me ditë se pse këto investime janë më proritare në krahasim me të tjerat. Në anën tjetër kemi projekte për të cilat egzistojnë kontrata dhe të cilat janë lënë në gjysmë, nuk janë duke u realizuar. Nëse i shohim projektet që janë të vendosura këtu pjesa e subvensioneve dhe transfereve nuk është e shpjeguar saktë për qka shkon, unë dëshiroj me ditë konkretisht dhe në formë të shkruar sepse e keni sjellur pa shpjegim për mallra dhe shërbime, pse kjo shumë më e madhe ose më e vogël, ndërtimi i rrugëve me kubza që janë të përmendura këtu, nëse i referoheni buxhetit 2020-2019 e shihni që këto rrugë janë të përfshime dhe pse këto rrugë janë futur prapë e nuk janë futur dhe disa rrugë tjera që janë me kubza aty.

Ndërtimi i objektit të emergjences, ka pasur mjete të ndara për ndërtimin e objektit të emergjences, mjete shtesë , tejkalim dhe qdo projekt i Komunës që bëhet me ndërtime më së paku e ka 10%, tentohet me fitu kompanitë më të lira kurse në anën tjetër vlera që e merr secili projekt që zbatohet e tejkalon kompaninë e dytë ose të tretë që është diskualifikur në emer të punëve shtesë që në fakt janë punë që është dashur mu kry aty, pra e njejta ndodh dhe me ndertimin e objektit të emergjences.

Ndërtimi i fushës sportive, unë jam duke u quditur si këta i fusin këto projekte këtu për së dyti herë, na e dimë që këto fusha tashmë egzistojnë, janë duke u ndërtuar dhe është bërë kontrata për këtë dhe e dimë që kontrat nuk mundesh me ba ti pa i pasur mjetet e zotume. 150.000€ në buxhetin e vitit 2019 kanë qenë të ndara për ndërtimin e fushave sportive në Bardhë, Carralluk, Gullbovc, Lladrovc, Shkozë dhe përveq këtyre 150.000€ edhe 140.000€ janë kërkur. Cili projekt i 2019 është realizu dhe cili nuk është realizu, ne nuk kemi marrur përgjigje dhe duke e parë trendin e zhvillimit të projekteve të vitit 2019 në Malishevë rrjedhja logjike e imja më qonë që ky projekt është i njejti, por nëse nuk është realizuar, pse ka dështu. Si ka mundësi që është nënshkruar kontrata pa asnjë mjet në dispozicion sepse gjyma e punve është kryer në këto shkolla . Rregullimi i oborrit të shkollës në Bubavec dhe Llozicë, këto janë projekte të parapame, kanë qenë të përfshime në vitin 2019-2020, por nëse nuk kanë ndodhë arsyen pse nuk kanë ndodhë. Projekti te arsimit fillor 350.000€ që e kanë kërkuar, po ju tregoj shumat që janë ndarë deri tash për këto dy projekte, 170.000€ shuma në vitin 2019 ka qenë projekti i planifikuar për Gurbardhin, 130.000€ në vitin 2020 për Gurbardhin dhe Maralin, jemi duke folur për Maralin si aneks, dhe me sa e di unë aneksin kur është bërë planifikimi ka qenë një shumë më pak se 100.000€ kurse 70.000€ janë të planifikume tash kur po flasim që po lypin bartje 350.000€, në buxhetin 2021 i kemi dhe 70.000€ shtesë. 700.000€ po kërkohen për shkollën në Gurbardh dhe aneksin në shkollën në Marali.

Unë i kisha propozuar disa alternative në lidhje me tratimin e saj, e para kisha kërkuar nga Kuvendi që

mos të marr vendim sot pa dhënë përgjigje në të shkruar, si Kryetari ashtu dhe drejtori shqetësimeve e miat dhe të juajet që i keni i ngrit, e dyta është që ne ta presim dhe kohën kur ta bëjmë shqyrtimin e e buxhetit 2021 dhe tek atëherë duke bërë krahasime me informatat shtesë që këta na sjellin sa janë realizu, sa nuk janë realizu dhe sa pritet me u realizu dhe në projektet që kanë mbetur me justifikim konkret pse kanë mbetur pa u realizuar këto projekte, ku kanë shkuar mjetet që i kemi dedikuar për këto dhe alternativa e tretë që mendoj që kish me qenë më e lehta për ne si asamble që Drejtorja e Arsimit të na sjellë koston e publikimeve që i kemi në kuader që kontrates kolektive për mësimdhënësit dhe gjitha mjetet që janë të parapame për mbulimin e shpenzimeve në realizim të kontrates kolektive për mësimdhënësit të realizohen nga këto mjete. Faleminderit!

Rrahim Morina: Pershendetje për gjithë të pranishmit! Së pari është dashur të jetë një specifik e gjithë këtyre projekteve që kanë planifikuar ti bartin mjetet, psh. ku mendojn me i qu 80.000€, ku thotë për subvensione dhe transfere dhe mallra dhe shërbime 350.000€, bartja për kubza 40.000€ kjo është hera e dytë që përsëriten, janë dy tri projekte që i kemi votuar si Kuvend në bartjen e mjeteve të vitit 2018-2019-2020, ne votojmë në Kuvend dhe këto nuk realizohen vetëm merret vendimi dhe këto i qojnë krejt tjetër kah, në një formë vendimet e Kuvendit janë krejt boshe, nuk e kanë atë vleren atë karakterin zbatues. Unë mendoj që nëse është bërë bartja e mjeteve për pagesen 40.000€ për rrugë me kubza, kjo çështje nuk është dashur me ardhur dhe një herë, ku kanë shkuar ato 40.000€ që ne i kemi bartur me bartjen e mjeteve të vitit 2018-2019 në vitin 2020. Te ndërtimi i fushave të bartja e mjeteve e ki vendimin që e kemi marur, ku kanë mbetur ato mjete që i kemi ndarë për ndërtimin e fushave. Qdo vendim i Kuvendit duhet me u zbatu, nëse thuhet që për ndërtimin e kubzave me shku 40.000€ duhet me shku aty dhe kubzat mos me na ardhur dhe një herë, ndërtimi i fushave nuk ka nevojë me na ardhur dhe një herë, ne i kemi ndarë mjetet ka kan shkuar ato mjete.

Para tenderimit të projekteve së pari bëhet zotimi i mjeteve, nuk ka mundësi me u tenderu pa u bërë zotim të mjeteve, sepse nuk lejohet me ligj. Qdo projekt i ka pasur të zotume mjetet. Është mirë qeveria egzekutivi me i marrë shumë serioze vendimet e Kuvendit.

Çështja që për mua është e rëndësishme është paga jubilarë dhe çështja e shujtave të mësimdhënësve, unë po e lusë dhe drejtorin dhe kryetarin le ta sjellin shumën e cila është e planifikume për pagesa të shujtave, ti paguajm këto pagesa dhe mos të na prishen projektet sepse brenda vitit kanë mu bërë gjitha pagesat e mësimdhënësve. Faleminderit!

Rrahim Morina: Sadije Krasniqi e ka fjalën.

Sadije Krasniqi: Faleminderit Kryesues! Pershendetje Kryetar, drejtor, antarë të Kuvendit dhe gjithë ju të pranishëm në sallë! Sa i përket këtyre mjeteve të këti fonit rezervë, unë pashë tabelen këtu në një

farë forme janë planifikuar disa projekte në disa fshatra, unë nuk jam kundër këtyre planifikimeve, mirëpo unë kisha thënë që këto planifikime të shkojnë në bazë të prioriteteve, ta keni parasysh gjithmonë këtë. Të nderuar anëtarë të Kuvendit e kemi dhe buxhetin për vitin 2021, unë kërkoj nga ju që gjithmonë të vlersohet dhe të shkojnë në bazë të prioriteteve. Unë kam një kërkesë nga ju që të përkrahet që në kuader të këtyre mjeteve dhe vitin e kaluar nuk jam pajtuar me buxhetin sepse Drenovci po anashkalohet, është një ndër fshatrat më të mdhaja të Komunës së Malisheves prandaj nuk po ndahet buxhet sa duhet për Drenovcin. Unë në bazë të këtij fondi po kërkoj që shkolla "Bajram Curri" që është e dëmtuar dhe ka nevojë për rinovim dhe numrin e nxënësve e ka shumë të madh ka nevojë për një aneks dhe kërkoj që kjo shkollë të këtë ose renovim ose një aneks. Faleminderit!

Rrahim Morina:Nebi Bibaj e ka fjalën.

Nebi Bibaj:Faleminderit Kryesues! I nderuar Kryetar, drejtor, kolegë asambleistë ! Te bartja e mjeteve që kanë tepruar prej pjesës së rritjes së pagave, Kryetar, drejtor për disa projekte që po shihen është hera e 4 që janë duke bërë projekte për këto, mjete po ndajmë minimum 4 herë.Çfarë obligime ka Komuna që ne vazhdimisht jemi duke ndarë mjete , ndajmë mjete për fusha sportive, ndajmë mjete për rrugë me kubza , në vitin 2018-2019-2020 ndajtum mjete, tash mjete për të njëjtat projekte, kjo po më shqetëson që ju jeni duke larë borgje të mëdhaja të cilat nuk i keni bërë të ditura asnjëherë para antarëve të Kuvendit, para qytetarëve të cilët ju kanë besuar voten, saktësisht është mirë me u identifiku borgjet ku janë. Unë personalisht për hirë të qytetarëve, për hirë të projekteve do ti mbështes, mirëpo është hera e fundit që do ti mbështesum të njëjtat projekte në vazhdimi që po ndodhin 2018-2019-2020 dhe kjo. Faleminderit!

Rrahim Morina: Raimonda Krasniqi e ka fjalën.

Raimonda Krasniqi:Pershendetje për të gjithë të pranishmit! Ne e kemi diskutuar dhe në mbledhjen e KPF, shumë prej projekteve të cilat vazhdimisht po devijohen, po ndryshohen, po paraqiten projekte të reja në rrugë edhe në vende të tjera, përveq atyre që ne i kemi miratuar në këtë asamble unanimisht me hartimin e projekt-buxhetit nga gjithë bashkarisht. Ajo qka më shqetëson pak më shumë është rindërtimi i qendres shëndetësore në Terpezë, me vendim të asmbles komunale ne bashkarisht kemi miratuar ndërtimin e një qendre të shendetësis familjare të re nga fillimi, për shkak që drejtori i shendetësisë na ka thënë nuk bënë të renovohet ai objekt që është aktual, është shumë i demoluar, shumë i dëmtuar dhe në të vërtetë ka bërë renovim të atij objekti dhe nuk ka ndërtuar objekt të ri. Pse u rregullua ai objekt tash mund të merimetohet, riparohet vetëm nga ana jashtme, njëfarë fasad e bukur

për të paraqitur që është e re dhe ku kanë shkuar parat që ne i kemi ndarë me vendim të kësaj asamble. Faleminderit!

Rrahim Morina: Avdi Morina e ka fjalën.

Avdi Morina: Faleminderit Kryesues! Pershendetje Kryetar, drejtor, të nderuar kolegë, të nderuar të pranishëm! Shefi i grupit parlamentar Sylja e dha qendrimin dhe opinionin sa i përket kësaj pike të rendit të dites, desha të kyqem në një debat duke falenderuar dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës për mundësin që na ka dhënë që mjetet të cilat kanë mbetur pa u realizuar si rezultat i mos hyrjes së ligjit të pagave në fuqi, që këto mjete financiare të barten në projekte kapitale për secilen Komunë veç e veç dhe në kuader të këtyre përgaditjeve që i ka bërë egzekutivi, ky vit ka qenë jo i mirë për të gjithë ne ku një pjesë e projekteve të cilat kanë qenë të parapame nuk janë realizuar, ndoshta jo krejtësisht si pasojë e virusit Covid, mirëpo ndoshta mund të ketë dhe ndonjë ngecje nga ana e dikastierëve të caktuar. Ajo që është me rëndësi ju ka dhënë një mundësi që ato të meta që kanë ndodhur ti riparojmë së bashku këtu, që këto mjete mos të shkojnë në suficid mirëpo të shfrytëzohen në projekte të cilat janë duke u zhvillur. Kryetar ju bëjë një ftesë që projektet që realizohen të kenë një mbikqyrje pak më të madhe, ndoshta është më mirë që të shtohet dhe numri i mbikqyrësve që të mos kemi telashe gjatë realizimit të projekteve. Meqenëse janë projekte në interes të qytetarëve ti votojm, unë e di që ka dhe shumë projekte tjera që presim me u realizu, mirëpo jemi në prag të hartimit të projekt-buxhetit të ri për vitin e ardhshëm, kështu që gjithë ato të meta të atyre projekteve i vendosum në projektin e ri. Ju bëjë ftesë gjitha grupeve politike, asambleistave që ta përkrahin propozimin e paraqitur këtu para nesh. Faleminderit!

Rrahim Morina: Hidajete Mazreku e ka fjalën.

Hidajete Mazreku: Faleminderit Kryesues! Pershendetje Kryetar, drejtora dhe kolegë asambleistë! Unë dëgjova dhe parafolësit e mi në lidhje me rezervat apo fondi që ka mbetur nga ligji për pagat që i kemi aprovuar në buxhet. Mirëpo këtu po e shohë konfuzë nga qeveria dhe nga Komunitat. Qeveria që 4 vite nuk e bënë nivelizimin e pagave në bazë të kontratave kolektive, e ka lënë si vetë Komunitat me vendos, unë dhe para 4 viteve kam debatuar në lidhje me këtë, qeveria duhet me u mirr me të, kjo është një kritik për qeverinë. Gati 5 vjet mos me qenë në gjendje me bënë nivelizimin e pagave ose shtesave që dalin nga kontrata kolektive, të gjitha Komunitat jemi duke u ballafaquar me këto. Këtu qeveria thotë mos të ndahen mjete për pagat dhe mjetet shtesë, ajo më tëper aludonte te Covidi 19 ose te shtëpitë shëndetësore. Unë sot nuk mundem me vendos për këtë sepse nuk kemi material të mjaftueshëm që

këto mjete ti tranferojmë diku tjetër. Shumë asambleista nuk janë të kënaqur se kjo Komunë me shumë ose ajo, drejten me thënë Komuna e Malisheves nuk kishte asgjë vetëm do kubza, mirëpo ato kubza kanë qenë të parapame. Drejtor dëshiroj të specifikohen këto mjete dhe pse pasi që u ngrit kjo çështje që të mundën shtesat të transfermohen tek pagat jubilarë, tek shujtat, këtu ju keni cekur që nuk bënë tek pagat jubilarë, dhe tek shujtat mirëpo më tepër tek kategorit ekonomike ose tek pandemia. Këto të vinë më të specifikume se ku do të shkojnë dhe qka do të bëhet me to, si do të punohet në to, a do të bëhet tenderimi apo janë të tenderume. E lus qeverien që mos të na banë këto që gati 4-5 vite që jemi duke u ballafaquar, le ta zgjedh çështjen qeveria, ajo është organi më i lartë, ajo i dedikon Komunitat e jo Komuna me u ballafaquar me këto. Faleminderit!

Rrahim Morina: Alban Mazreku e ka fjalën.

Alban Mazreku: Pershendetje të nderuar asambleistë, Kryetar, Kryesues, të nderuar drejtor! Për çështjen e Drenovcit që nuk është investuar fare atje, fajtor kryesor për këtë është vetë qeverisja e Nismas e cila udhëheqë me Komunën e Malisheves që nga viti 2013 dhe për faktin e vetëm që janë lidhur me disa inate politike për shkak se ne dojmë me ndërtu atje e ju keni thënë këtu dhe kanë stopuar projektin e Ministries së Kultures vetë Komuna jonë, jo vetëm për këtë por dhe nuk kanë qenë në gjendje me ba një projekt. Komuna jonë asnjëherë nuk e ka dërguar një projekt të detajuar për investime të salles së sportit në fshatin Drenovc të "Bajram Curri".

U përmend këtu shujtat në arsim, kjo mundet me u planifiku dhe me buxhetin sivjet që do të bëhet për vitin e ardhshëm. Kryetar këtu po shihet që keq menaxhim të buxhetit komunal ka, mbikqyrje ka vetëm me letra, më pelqej Avdia që tha me e rrit numrin e mbikqyrësve ose ta merr shembull Kryetarin e Drenasit Ramiz LLadrovcin i cili vetë del në teren dhe i stopon punët që nuk po kryhen ashtu qysh janë të planifikume në projekt. Drejtori Ahmeti nëpër perurimet e investimeve nëpër fshatra kur po i bëjnë tash po i thirr dhe asamblesitat e atyre zonave, mirëpo filloj zgjerimi i rrugës për Bajë "Gjergj Kastriot Skenderbeu" u bë një perurim aty dhe nuk e kanë thirr as kryetarin e qytetit, ka gjykime të jashtzakonshme politike.

Në projekt Valoni e ka paraparë dhe renovimin e oborreve të shkollave dhe të objekteve, shkolla fillore "Ibrahim Mazreku" po renovohet disa herë mirëpo zgjidhje nuk po bahet asnjëherë. Shkolla jonë është shkolla më e madhe në Komunë të Malisheves, ajo pa pandemi është problem e leje më gjatë pandemies. Kryetar dhe drejtor asnjë projekt të Infrastruktues në qytetin e Malisheves nuk e keni bërë, qyteti i Malisheves ndoshta është qyteti më i pa pastër në Kosovë. Kryetar ose përdore inspektoriatin e Komunës që e keni në disponim, ai që nuk e respekton le ta dënon atë dhe le të

pastrohen rrugët. Po thu ndërtimi i shkollës është duke u bërë nga Ministria e Arsimit, mirëpo po i bjen fundi i mandatit të dytë pa u përfunduar ajo shkollë dhe investimi i çerdhes në lagjen e re dhe nuk e keni bërë këtu ku e keni premtuar dhe kjo është për mu qudit, besoj dhe qytetarët kanë me ndryshuar vendimin për votim. Është viti i 7 i qeverisjes dhe asnjë kubzë në qytetin e Malishevës nuk është lëviz, kjo është për turp.

Rrahim Morina: Halil Morina e ke fjalën.

Halil Morina: Faleminderit Kryesues për fjalën! I nderuar Kryetar, të nderuar drejtor dhe ju asambleistë! Shqetësimet kryesore këtu që u transmetun prej kolegëve, pse disa projekte që i kemi në projekt buxhet na kanë ardhur prapë të fondi rezervë. Problemi i parë i jonë është se sa herë që ne kemi miratuar buxhet, kemi planifikuar më shumë se sa kemi mjete dhe kemi planifiku me kosto jo reale, psh një meter kanalizim e kemi planifikuar me një kosto shumë më të vogël se vlera në treg është shumë më e madhe, dhe për ata nuk kemi mundur me i realizu gjithë këto projekte, për këtë disa projekte duhet me u bart prapë në këtë fondin rezervë. Shqetësimet e juaja dikun dikun janë me të drejtë është dashur me pas më shumë sqarim, më shumë specifika, mirëpo më e domosdoshme është me u mir një vendim sot se me u shty, nuk guxojm ne me i shty gjërat sepse jemi në fund të vitit fiskal, në qoftëse vazhdojmë me i shty gjërat kto pare kanë me na humbur, kanë me na shku në suficid. Unë kërkoj prej juve që të votohet të merret një vendim dhe ato pare ti shtim në projekte.

Rrahim Morina: Ilaz Krasniqi e ka fjalën.

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Ajo qka më shtyri ta marrë fjalën është fjala e parafolesit ku thotë që paralogaritë që i kemi bërë në buxhet dhe qmimet që i kemi ndarë për meter të kanalizimit apo të asfaltit nuk janë bërë mirë, mirëpo këtu i kemi dëgjuar dhe Drejtorin e Financave se në buxhet nuk janë paraparë qmimet ose ka gabuar në hartimi e buxhetit që nuk i ka paraparë qmimet e sakta sa kushtojnë, ndërsa Drejtori i Urbanizmit thotë se më kanë tepruar mjetet në një projekt të një fshati dhe i kemi futur në projektet që janë duke u shtruar rrugët që nuk janë në projekt buxhet, nuk po e di cili e ka drejt.

Kryetar ne e kemi votuar një buxhet si Kuvend, pse kerkohet kur ju i vendosni ato proritete e juaja ku të doni me investu kur është i votuar ose nuk është në projekt buxhet, që ke shumë projekte që janë duke u realizuar që janë të pabuxhetune. Projektet e vitit 2019 për fshatin Carralluk që kanë qenë të votuara në këtë Kuvend nuk janë kryer, viti 2020 asnjë projekt, pse atëherë po votojm, pse po hartohet një

projekt buxhet, cila është puna e këtij Kuvendi dhe cila është detyra e ekzekutivit ?

Unë mendoj që ky Kuvend është duke gabuar perderisa i ka votuar disa projekte dhe Komuna nuk lëmerr për bazë ato vendime të cilat i ka nxjerr Kuvendi. Faleminderit!

Rrahim Morina: Urdhëro, Alban!

Alban Krasniqi: Ato propozimet pak i artikulovala si alternative në fjalimin tim, po shihet që ka pasur pazar në tovolina, pazar politik në këtë punë dhe janë adresuar tek do interesat të ngushta mahallore dhe kjo ka bërë që një pjesë e njerëzve me aq me u mjaftu. Po më vjen mirë që asambletë të Nismes ndonëse janë në pushtet ishin shumë më objektive se disa tjerë, sepse është shqetësim real shpërndarja e pa barabartë, mënyra e shpenzimeve të mjeteve, mos transparenca se çka është realizu dhe çka nuk është realizu. Kolegëve të PDK-së po ju përkujtoj që janë po këta që kanë qenë këmbëngulës që ti dërgojm, rastet të ngjajshme i kemi dërguar në Prokurori, tek organet e drejtësisë dhe tash deklarohen se kanë me mbështet këtë ndryshim, që ka elemente për mua të njëjta që duhet të dërgohet në Prokurori sepse mungesa e informacionit të bërë me dyshu, sepse dy tri herë është projektu e njëjta gjë, dhe tash dojnë me i votu. Unë do ti pësë a do të shkojnë në të njëjtën kohë dhe ti hërheqin së paku nënshkrimet dhe vendimet që i keni marrur kur i kemi dërguar ato lëndë në Prokurori dhe krejt është në rregull. Damin që po ja sjellni buxhetit është i pariparushëm dhe pranimi i praktikave të këqija që po e bëni duke i votuar është gjithashtu në kundërshtim me atë që e keni votuar ju dhe ne bashkërisht.

Janë disa alternative 1.a doni me dal si grupe me diskutu dhe shiku se çka mundemi me ndryshu, a jeni ti japim prioritet realizimit të pagave jubilarë dhe shujtave sipas kontratës kolektive .

Propozimi im i dytë është që të ulemi dhe ti ridiskutojm me shefat e grupeve nëse ka vullnet, nëse nuk ka pazar. Nëse jeni të interesun dhe me i adresu dhe shqetësimet e asambleistëve të tjerë të ulemi dhe të shikojmë dhe merremi vesh ose ti adresojmë me prioritet të pagat jubilarë, sepse në fund të fundit po na marrin perseri ,që konsideroj që është e padrejt .

Rrahim Morina:Unë kam një propozim konkret timin që të hyjnë pagat jubilarë dhe shujta, se mesa kam informacion 350.000 mallra dhe shërbime janë të planifikime për pagesën e shujtav , 80.000 janë për pagesat për nënat lehonat që është 100€ . Po ju bëjë thirrje dhe një herë ta analizojmë ta gjykojmë drejt pa anime sepse këto parë kanë me i marr, kështu që ma mirë mos ta prishin neser projektin dhe propozimin konkret unë do ta lexoj. Meqë janë projekte të përsëritura 40.000 është kodi 667577, kodi shëndetësisë është 37800 janë 40.000, 140.000 janë për ndërtimin e fushave sportive që është e

persëritur i kemi bartur mjetet, 40.000 është renovimi i oborrit të shkolles Bubavec dhe Llozic dhe të gjitha këto mjete që bëjnë 280.000 të barten në kodin e arsimit fillor në 93360 dhe të shkojnë për pagesa të shujtave, për shkak se niveli qendror kur të thirr me ja ba pagesen për shujta ai të thotë nga cili projekt don me i marrë, ne si Kuvend mundemi me I thanë këtu në këtë projekt me I marrë.

Avdi Morina: Mbledhja është thirrur me kërkesë të Kryetarit të Komunës z. Ragip Begaj, pikërisht për këto ndryshime që i kemi bërë. Ne e kemi një propozim që e ka bërë Kryetari i Komunës dhe propozimi i Kryetarit të Komunës del në votim, në qoftëse nuk kalon ky propozim atëherë vinë alternativat tjera, propozimet tjera që mundën me shku. U diskutua dhe për pagat jubilarë dhe shujtat dhe këto janë të parapame këtë ndryshime. Ne kërkojmë që të hidhet në votim kjo pikë. Faleminderit!

Rrahim Morina: Së pari Albani e ka një kërkesë që grupet parlamentare nëse kanë nevojë për një konsultim paraprak rreth kësaj çështje, është propozimi im i dyti dhe i Kryetarit vjen në fund. Kjo është praktik, kështu kemi vepruar gjithmonë.

Alban Krasniqi kërkoj një konsultim 5 minuta, kush është për me ngritje të dorës?

Për: 6

Kundër: 15

Apstenim: 3

Nuk kalon propozimi Albanit.

Shkojmë te propozimi i imi me u bartur mjetet nga ato kategori për pagesat për mësimdhënësit
Kush është për?

Për: 5

Kundër: 15

Apstenim: 4

Nuk kalon as propozimi im.

Propozimi i Kryetarit, kush është për?

Për: 19

Kundër: 1

Apstenim: 1

Me 19 vota për, 1 kundër dhe 1 apstenim kalon propozimi i Kryetarit. Kalofshi mirë!

Mbledhja përfundoi në ora: 11:40

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina

